



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare
www.legjislacioni.gov.al

Nr. 48

Datë 9 prill 2014

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Rregullore e MBZHRAU Për zbatimin e ligjit nr. 64, datë 31.5.2012 “Për peshkimin” 1279
nr. 1, datë 7.3.2014

RREGULLORE
Nr. 1, datë 7.3.2014

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 64, DATË
31.5.2012 “PËR PESHKIMIN”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Shqipërisë, nenit 135 të ligjit 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Prodhimeve Bujqësore dhe të Politikave Tregtare, ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, nxjerr këtë rregullore.

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizime

I. Në kuptim të kësaj rregulloreje:

1. “Akti i miratimit” është një dokument që lëshohet nga Ministria për të kryer një aktivitet të veçantë peshkimi me një anije të caktuar, në kushte të përcaktuara dhe në të cilën certifikohen minimalisht të dhënat në lidhje me identifikimin e karakteristikave teknike dhe të ndërtimit të anijes.

2. “Bashkëmenaxhimi i peshkimit” është ajo formë e menaxhimit të burimeve peshkore, ku përgjegjësitë dhe kompetencat janë të ndara ndërmjet shtetit dhe përdoruesve lokalë (organizatave). Procesi institucional i bashkëmenaxhimit mund të jetë i formave të ndryshme në lidhje me përgjegjësitë dhe kompetencat.

3. “E dhënë personale”, kuptohet emri dhe adresa e pronarëve të anijeve të peshkimit.

4. “Flota” është numri total i anijeve të peshkimit, që shfrytëzon një burim të caktuar. Flota mund të përbëhet nga anije që kryejnë një tip (p.sh. pelagjik) ose tipa të ndryshëm peshkimi (p.sh. fundor, artizanal e pelagjik).

5. “Intensiteti i peshkimit” është sforcë e peshkimit për njësi hapësirë-kohë, p.sh., orët që kryhet një peshkim fundor në një zonë të dhënë.

6. “Kapacitet peshkimi” quhet sasia e peshkut që mund të merret nga një njësi peshkimi, p.sh., nga një individ, komunitet, anije ose flotë, duke marrë si të mirëqenë që nuk ka kufizim në zënie. Matja e kapacitetit të një anije bazohet në një formulë që lidhet me tonazhin e anijes dhe fuqinë motorike të saj: $gjatësia (m) \times zhytja (m) + 0.45 \text{ fuqi motorike (KW)}$.

7. “Kontrolli i sforcos” (input) është një sistem i menaxhimit të peshkimit që fokusohet në kufizimin e sasisë së mjeteve të peshkimit ose të kohëzgjatjes së përdorimit të saj, si edhe në kufizimin e sasisë së peshkut të zënë. Këtu përfshihen lejet e peshkimit dhe ditët në det.

8. “Ligj”, kuptohet ligji nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar.

9. “Masë paraprake e menaxhimit të peshkimit”, kuptohet masa që merret në rastet kur mungojnë të dhënat shkencore të përshtatshme, të cilat mund të shtyjnë në kohë marrjen e masave menaxhuese për mbrojtjen e specieve objekt peshkimi, të specieve të bashkëlidhura me to dhe/ose që varen nga to, si dhe të specieve që nuk janë objekt peshkimi dhe të habitateve të tyre.

10. “Masat për konservimin biologjik” janë masa të menaxhimit të peshkimit që merren për specie të veçanta ose stokut të peshkut, si edhe të metodës së peshkimit. Këtu përfshihen edhe sasi të minimale të zënies, zonat e mbyllura, kuotat e zënies etj.

11. “Momentale (*snapshot*)”, kuptohen të gjitha ngjarjet e regjistruara për anijet që bëjnë pjesë në flotën e peshkimit që nga data e censimit deri në datën e verifikimit të të dhënave.

12. “Monitorimi, kontrolli dhe mbikëqyrja (MCS)” është “arma ekzekutive” e menaxhimit të peshkimit. MCS nuk është një mbrojtje e peshkimit, një veprimtari policore ndaj kundërvajtësve, vetëm një zbatim në terren, vetëm një masë frikësuese, një veprim ushtarak apo vetëm një përgjegjësi e shtetit. MCS është një sistem, i cili bëhet aktiv me përkrahjen dhe pjesëmarrjen e grupeve të interesit.

13. “Mortaliteti i peshkimit” është një term teknik, i cili i referohet pjesës së popullatës peshkore, që eliminohet nga peshkimi në një njësi kohe të dhënë.

14. “Mortalitet pas peshkimit” (*by-mortality*) është mortaliteti (ngordhja) që shkatohet nga mjetet e peshkimit gjatë procesit të zënies, për burimet ujore të gjalla që i shpëtojnë mjetit (pajisjes) të peshkimit. Një shembull është peshku që ngordh nga infeksionet ose nga prishja e ekuilibrit osmotik, që shkatohet prej humbjes së luspave nga fërkimi me rrjetën (trata koçet) ose nga ngecja në syzet e rrjetave (mrezhat).

15. “Ngjarje”, kuptohet hyrja ose dalja nga flota e peshkimit e një anijeje, si dhe modifikimi i një prej të dhënave.

16. “Njësi operative” (sipas KPPM-së), për qëllime të menaxhimit të sforcos së peshkimit, kuptohet një grup anijesh peshkimi që praktikojnë të njëjtin lloj peshkimi, duke peshkuar të njëjtat lloje peshqish ose grup peshqish dhe që kanë një strukturë ekonomike të ngjashme. Grupimi i anijeve të peshkimit mund të ndryshojë me kalimin e kohës dhe varet nga objektivat menaxhuese që do të zbatohen.

17. “Palë e interesuar” ose grup i interesuar që i referohet çdo personi ose grupi të njohur nga shteti ose shtetet që kanë një interes legjitim në ruajtjen dhe menaxhimin e resurseve që menaxhohen. Ky term është më përfshirës se termi “*stakeholder*”. Duke folur

në përgjithësi, kategoritë e palëve të interesuara shpesh do të jenë të njëjta për shumë peshkime dhe mund të përfshijnë interesa të kundërta tregtare, çlodhëse argëtues, ruajtje shfrytëzim, artizanal, tregtar, peshkatar, blerës, përpunues, lokal dhe shtet. Publiku dhe konsumatorët në përgjithësi, gjithashtu, mund të konsiderohen si palë të interesuara në disa rrethana.

18. “Peshkimi fantazmë” (*Ghost fishing*), përdoret për të përshkruar zënien e organizmave detarë nga ana e mjeteve të braktitura të peshkimit. Ky është veçanërisht problem me mrezhat e njicat dhe si një peshkim i padëshiruar që mund të paraqesë një problem serioz në shumë zona, duke shkaktuar mortalitet për një periudhë të gjatë kohe.

19. “Peshkim me mjete pasive ose stacionare”, kuptohet peshkimi me çdo lloj pajisje (rrjetë, kallam ose tub plastik a metalik i thurur etj.) e fiksuar, e vendosur për zënien e organizmave ujorë, si p.sh.: dajlanë, prita, bilance, stavnikë etj.

20. “Peshkim pelagjik” kuptohet peshkimi i llojeve të peshqve që jetojnë në shtresën ujore ndërmjet fundit dhe sipërfaqes, qofshin këta të vegjël apo të mëdhenj (sardelja, açuga, toni etj.).

21. “Peshkim me rrethime” kuptohet peshkimi i llojeve të ndryshme të peshqve me rrjeta që mundësojnë rrethimin e tufave (sardelja, açuga, toni) të grumbulluara për shkaqe biologjike ose jo.

22. “Pikë referimi” është një vlerë e caktuar (e vlerësuar) e nxjerrë nga një procedurë shkencore ose nga një model, i cili i korresponдон një gjendje të resursit apo të peshkimit dhe mund të përdoret si tregues për menaxhimin. Disa pika referimi janë të përgjithshme dhe të aplikueshme për shumë stoqe peshqish, të tjerat duhet të jenë për stoqe specifike. Një dallim duhet të bëhet midis pikave që kanë të bëjnë me objektivat dhe pikat që kanë të bëjnë me kufirin apo pragun dhe që përfaqësojnë gjendjen kritike të stokut.

23. Me “qendër peshkimi” kuptohet një mol, urë në det ose valëpritis, në lagunë ose në liqen, i cili përdoret për qëllime peshkimi së bashku me territorin tokësor, ndërtesat dhe strukturat përkatëse.

24. “Rekrutet” për një stok janë individët e grup-moshës se re të popullatës, që futen për herë të parë në pjesën e shfrytëzuar të stokut ose peshqit e moshës në rritje ose ndryshe që bëjnë pjesë në atë komponent të shfrytëzueshëm.

25. “Rrjeta grumbulluese”, rrjeta të përbëra nga një copë e vetme dhe të mbajtura vertikalisht në ujë nëpërmjet plumbit dhe galexhanteve (tapave); përdoret për të peshkuar organizma ujorë të gjallë që ngecen në rrjetë ose në syzet e saj; në varësi të plumbit dhe të tapave, këto rrjeta mund të përdoren për të peshkuar në kolonën e ujit deri në sipërfaqe (rrjeta grumbulluese

fikse notuese dhe rrjeta grumbulluese lundruese) ose në afërsi të fundit (rrjeta grumbulluese të hedhura në fund).

26. “Rrjeta me rrethim”, kuptohen rrjetat që kapin peshqit, duke i rrethuar nga anët dhe nga poshtë.

27. “Rrjeti kohë-hapësirë” do të thotë kombinimi i një areali gjeografik në një sektor të përcaktuar dhe në një interval kohe të caktuar.

28. “Selektiviteti” është një aftësi e mjetit të peshkimit për të përzgjedhur një specie gjatë procesit të peshkimit. Selektiviteti i mjeteve të veçanta të peshkimit varet nga aftësia e tyre për të seleksionuar speciet objekt peshkimi (target) nga shumëllojshmëria e pranishme e organizmave në zonën ku po zhvillohet aktiviteti i të peshkuarit. Selektiviteti total i një metode peshkimi është një rezultat i kombinuar i veçorive karakteristike të mjetit të peshkimit dhe të metodës së zbatuar të peshkimit.

29. “Shfrytëzim i qëndrueshëm”, kuptohet shfrytëzimi i një popullate peshkimi në mënyrë të tillë që shfrytëzimi i tij në të ardhmen të mos rrezikohet ose që të mos ketë efekte negative mbi ekosistemet ujore.

30. “Shkalla e shfrytëzimit”, e zbatuar mbi një stok peshku, është pjesa ose sasia e biomasës së hequr si rezultat i peshkimit. Në qoftë se biomasa është 1000 T dhe zënia gjatë një viti është 200 T, shkalla vjetore e shfrytëzimit është 20%.

31. “Speciet objekt peshkimi (target)” janë speciet kryesore që duhet të zihen nga një anije ose një mjet në një tip peshkimi të caktuar. Në peshkimin pelagjik me koshilok kjo mund të jetë vetëm një specie (p.sh. sardelja), ndërsa në peshkimin me koça mund të jetë një grup speciesh (p.sh.: merluci, barbuni, gjuhëza etj.).

32. “Stavnik” është një mjet stacionar peshkimi, i cili përbëhet nga një krah pengues, i cili e drejton peshkun në një seri dhomash konike ose në formë piramide, gjithmonë e më të vogla deri te thesi i grumbullimit. Mund të jetë me shtylla ose me spiranca. Stavniku montohet në ujëra pak të thella, në laguna, në lumenj dhe në afërsi të bregut.

33. “Stok peshku” janë resurset e gjalla në komunitetin ose në popullatën nga të cilat merren zëniet në një peshkim. Përdorimi i termit stok peshku zakonisht nënkupton që popullata e veçantë është pak a shumë e izoluar nga stoqet e tjera të së njëjtës speciejë dhe si rrjedhim vetëqëndron. Në një peshkim të veçantë, stoku i peshkut mund të jetë një ose disa specie peshqish, por këtu, gjithashtu, synohet të përfshijë invertebrorët dhe bimët komerciale.

34. “Tonazh” kuptohet tonazhi bruto i përcaktuar nga aneksi i Konventës Ndërkombëtare mbi Tonazhin e Anijeve (1969). Tonazhi bruto përcaktohet me anë të formulës $GT=K1V$, ku V është volumi total i

hapësirave të mbyllura të anijes në metër kub dhe $K1=02+0.02\log 10V$.

35. “Vegla të tërhequra” është çdo vegël peshkimi që tërhiqet ose jo me anë të forcës motorike të një anijeje peshkimi ose nëpërmjet tambureve me anije të ankoruar ose në lëvizje me shpejtësi shumë të vogël, duke përfshirë në mënyrë të veçantë tratat ose dragat.

36. “Vlerësimi i stokut” është kërkimi, analiza dhe përshkrimi numerik i gjendjes aktuale dhe të kaluar të një stoku peshku dhe i aktivitetit të peshkimit që e shfrytëzon atë, domethënë, shpërndarja, abondanca, struktura e përmasave ose moshës, sforcos së peshkimit, nivelet e zënieve etj.

37. “Zënie” është numri total ose pesha e peshkut të zënë në një zonë brenda një periudhe të caktuar kohe. Zënia përfshin edhe peshkun e flakur në det dhe që nuk është zbarkuar në tokë. Zënia mund të bëhet në një zonë të ndryshme nga zona e zbarkimit të peshkut.

38. “Zënie për njësi të sforcos (CPUE)” është zënia totale e marrë për çdo njësi të sforcos (ditë në det, orë tralimi).

KREU II

PESHQIT DHE MBROJTJA E TYRE

Neni 2

Matja e dimensioneve të organizmave ujorë

1. Gjatësia e peshqve matet nga maja e turirit (me gojë të mbyllur) deri në ekstremitetin e lobit më të gjatë të pendës së bishtit (kaudale), ose në ekstremitetin e pendës së bishtit (kaudale) kur kjo nuk përbëhet nga dy lobe.

2. Gjatësia e krustaceve matet nga fillimi i syrit deri në ekstremitetin e prapmë të trupit, përfshirë bishtin.

3. Dimensionet e molusqeve bivalvare i referohen gjatësisë maksimale ose diametrit maksimal të guaskës së tyre.

Neni 3

Dimensionet minimale të disa organizmave ujorë

1. Ndalohet të peshkohen, të mbahen në bord, të zbarkohen, të transportohen, të magazinohen, të ekspozohen e të tregtohen organizma ujorë me dimensione më të vogla se ato të treguara më poshtë për çdo lloj të veçantë:

a) Peshqit

Emri shqip	Emri shkencor	Dimensionet
Merluci tripëndësh	<i>Micromesistius spp.</i>	20 cm
Qefujt	<i>Mugil spp.</i> , (<i>Liza spp.</i> , <i>Chelon spp.</i>)	16 cm
Dentalet	<i>Dentex spp.</i>	25 cm
Vopa	<i>Boops boops</i>	10 cm
Salpa	<i>Sarpa salpa</i>	12 cm
Korbët	<i>Sciaena spp.</i> , <i>Umbrina spp.</i>	25 cm
Stavridat	<i>Trachurus spp.</i>	12 cm
Gofat	<i>Seriola spp.</i>	30 cm
Amet	<i>Lichia amia</i>	30 cm
Pallamidi	<i>Sarda sarda</i>	30 cm
Sardelet	<i>Sardinella aurita</i>	11 cm
Shproti (papalina)	<i>Sprattus sprattus</i>	10 cm
Kublat	<i>Alosa fallax</i>	20 cm
Maridhat	<i>Spicara spp.</i>	8 cm
Toni	<i>Thunnus thynnus</i>	101 cm
Toni alalunga	<i>Thunnus alalunga</i>	40 cm
Tonili	<i>Euthynnus alletteratus</i>	30 cm
Peshku shpatë	<i>Xiphias gladius</i>	100 cm
Peshku pëllumb	<i>Mustelus spp.</i>	30 cm
Rajat	<i>Raja spp.</i>	30 cm
Skadhinat	<i>Squatina spp.</i>	40 cm
Peshqit elektrikë	<i>Torpedo spp.</i>	30 cm
Ngjalë deti	<i>Conger conger</i>	30 cm
Peshqit kitarre	<i>Rhinobatos spp.</i>	30 cm
Shojza	<i>Platichthys flesus</i>	15 cm
Shkotrat	<i>Bothus spp.</i> <i>Arnoglossus spp.</i>	30 cm
Rombet	<i>Scophthalmus spp.</i> <i>Psetta spp.</i> <i>Lepidorhombus spp.</i>	30 cm
Jatagani	<i>Lepidopus caudatus</i>	40 cm

Shtiza	<i>Sphyraena spp.</i>	25 cm
Peshku kovaç	<i>Zeus faber</i>	20 cm
Peshqit gjel	<i>Trigla spp. Aspitrigla spp.</i>	15 cm
Henëza e detit (lopa)	<i>Lophius piscatorius</i>	30 cm
Aterinat	<i>Atherina spp.</i>	8 cm
Ngjala	<i>Anguilla Anguilla</i>	25 cm
Trofta ylber	<i>Onchorhynchus mykiss</i>	25 cm
Trofta e egër	<i>Salmo trutta fario</i>	20 cm
Korani	<i>Salmo letnica</i>	32 cm
Korani i verës	<i>Salmo letnica estivalis</i>	30 cm
Belushka	<i>Salmothymus ohridanus</i>	30 cm
Sharroku (perka)	<i>Perca fluviatilis</i>	15 cm
Luçioperka	<i>Stizostedion lucioperca</i>	30 cm
Gjuca (cironka)	<i>Alburnus spp.</i>	10 cm
Njila (skobuzi)	<i>Chondrostoma spp.</i>	15 cm
Skortët	<i>Rutilus spp.</i>	12 cm
Mustakët	<i>Barbus spp.</i>	25 cm
Mrenat	<i>Cobitis spp.</i>	25 cm
Mlyshët	<i>Leuciscus spp.</i>	15 cm
Bordullakët	<i>Gobius spp.</i>	15 cm
Karasët	<i>Carassius spp.</i>	15 cm
Krapi	<i>Cyprinus carpio</i>	30 cm
Ballëgjerët	<i>Hypophthalmichthys spp.</i> <i>Aristichthys spp.</i>	30 cm
Amuri	<i>Ctenopharyngodon idella</i>	30 cm
Pëllëmbëza	<i>Megalobrama amblycephala</i>	20 cm
Açuga	<i>Engraulis encrasicolus</i>	9 cm

b) Krustacete

Karkaleci i detit	<i>Penaeus kerathurus</i>	7 cm
Karkaleci violetë	<i>Aristeus antennatus</i>	7 cm
Karkaleci i kuq	<i>Aristaomorpha foliacea</i>	6 cm

c) Molusqet cefalopodë

Kallamarët	<i>Loligo spp.</i>	25 cm
Totanët	<i>Ilex spp.</i>	30 cm
Sepia	<i>Sepia officinalis</i>	20 cm
Oktapodi	<i>Octopus vulgaris</i>	0.5 kg

d) Molusqet bivalvore

Midhja	<i>Mytilus galloprovincialis</i>	5.0 cm
Tartufi i detit	<i>Venus verrucosa</i>	2.7 cm
Telini	<i>Donax trunculus</i>	2.2 cm
Vongola verace	<i>Ruditapes decussates</i>	3.6 cm
Vongola filipinase	<i>Ruditapes semidecussatus</i>	3.0 cm
Ostrea	<i>Ostrea spp.</i>	6.0 cm
Biçaku	<i>Solen spp.</i>	8.0 cm
Fasolari	<i>Challista chione</i>	6.0 cm

2. Për peshqit me përmasa të vogla, që zihen me rrjeta rrethuese, si: sardelja, açuga, papalina e gjuca (cironka) lejohet që në sasinë e peshkuar të ketë deri 20% të sasisë totale nën dimensionet minimale respektive (pika 1 e këtij neni), por jo nën 7 cm gjatësi.

3. Në çdo konfeksion të prodhimit të peshkuar lejohet një tolerancë e molusqeve bivalvore me dimensione më të vogla nga ato të parashikuara jo më shumë se 10% të llogaritura në bazë të pikës 1 të këtij neni.

Neni 4

Ndalimi për të peshkuar disa lloje në periudha e zona të caktuara

Ndalohet të peshkohen, me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtja në bord, tranzitimi në barkë dhe zbarkimi i qëllimtë i llojeve të mëposhtme në periudhat e zonat respektive:

1. Gjuca (cironka) - *Alburnus albidus alborella* prej 20 prillit deri më 15 korrik në liqenin e Ohrit dhe 1 prillit deri më 31 korrik në zonat e tjera;

2. Krapë - *Cyprinus carpio* prej 20 majit deri më 15 qershor në liqenin e Ohrit,

15 prill deri më 15 maj në zonat e tjera;

3. Korani - *Salmo letnica* prej 1 dhjetorit deri më 28 shkurt në liqenin e Ohrit;

4. Belushka - *Salmothymus ohridanus* prej 1 nëntorit deri më 31 janar në liqenin e Ohrit;

5. Trofta e egër - *Salmo trutta* prej 1 nëntorit deri më 1 prill në të gjitha zonat;

6. Peshkimi i molusqeve bivalvore ndalohet në periudhën e mëposhtme:

a) vongole, kardium, fazolari, në periudhën 15 qershor deri më 15 korrik;

b) kanoliket, nga 1 prilli deri më 30 shtator;

c) telina nga 1 prilli deri më 30 prill;

d) tartufet nga 1 qershori deri më 31 korrik.

7. Gjatë periudhave të ndalimit të gjuetisë, sipas pikës 6 të mësipërme, lejohet ushtrimi i aktiviteteve të tjera të peshkimit të autorizuar me leje, pasi të jenë hequr mjetet e peshkimit të molusqeve bivalvore.

8. Ministria përcakton me urdhër të saj orarin e peshkimit të molusqeve bivalvore.

9. Ndalohet të kryhet aktiviteti i peshkimit të molusqeve bivalvore gjatë gjithë vitit në ditët e shtuna, të dielave dhe ditët e festave zyrtare.

10. Në raste të veçanta, brenda zonave të plazheve, peshkimi i vongolave, i kardiumit dhe i fazolareve ndalohet për periudha më të gjata, nga maji deri në shtator.

11. Ndalohet peshkimi në zonën me rreze 2 km nga grykëderdhja e lumit Bunë dhe 1 km nga grykëderdhjet e të gjithë lumenjve të tjerë të vendit.

12. Ndalohet peshkimi brenda zonës së shamadurit, si dhe vendosja e rrjetave të llojit mrezha, njica në drejtim të vijës kufizuese të shamadurit. Zona e shamadurit përfshihet brenda rrezes së poshtëshënuar (e llogaritur nga dajlani):

a) në dajlanin e Shkodrës 1000 metra;

b) në dajlanin e Cekës 1000 metra;

c) në dajlanin e Patokut 1000 metra;

d) në dajlanin 1 të Nartës 1000 metra;

e) në dajlanin 2 të Nartës 1000 metra;

f) në dajlanin e Butrintit 500 metra.

13. Ndalohet peshkimi sipër dajlanit të Pritës së Rrezes (Butrint) në distancë deri në 500 m. Ndalohet çdo lloj aktiviteti peshkimi me rreze 250 m nga ura (Prita e Rrezes - Butrint) në drejtim të liqenit të Bufit.

14. Ndalohen lejimi i më shumë se 10 grupeve peshkimi me dy peshkatarë në liqenin e Butrintit. Peshkimi në këtë liqen do të kryhet vetëm me rrjete mrezhe kaladore rrethimi (deri në 400 ml secili grup), paranca ngjale (deri në 6 copë secili grup) dhe parangallë. Ndalohet çdo lloj aktiviteti peshkimi përreth ishullit të Sazanit, në distancë prej 1 milje detare nga vija bregdetare ose në izobatën 50 metra, atëherë kur kjo thellësi arrihet në një distancë më të vogël.

15. Ndalohet çdo lloj aktiviteti peshkimi në bregun e jashtëm të Karaburunit, nga Kepi i Gjuhëzës te Rrugët e Bardha (Palasë) në distancë prej 1 milje detare nga vija bregdetare ose në izobatën 50 metra, atëherë kur kjo thellësi arrihet në një distancë më të vogël.

16. Ndalohet hedhja e çdo lloj rrjete me rrethim në distancë më të vogël se 300 m nga bregu ose në një izobatë prej 40 metrash kur kjo thellësi arrihet në distancë më të vogël.

17. Ndalohet peshkimi me trata tërheqëse (fundore ose pelagjike) në gjirin e Vlorës (i kufizuar në veri nga vija bazë prej kepit të Karaburunit deri në Treport).

Neni 5

Kanalet e komunikimit midis lagunave dhe detit

1. Ndalohet peshkimi në kanalet e komunikimit midis lagunave dhe detit, si dhe në zonën bregdetare të përfshirë brenda harkut me rreze prej 2 km me qendër në vendin e derdhjes së kanalit në det.

2. Gjatë periudhës kur dajlanët janë të mbyllur (në funksionim për zënien e peshkut), ndalohet peshkimi i të tretëve brenda kufirit të dajlanit (shamaduri nga ana e lagunës), që përcaktohen për çdo dajlan nga drejtoria ose ekspertë të autorizuar prej saj.

3. Ndalimi i mësipërm nuk është i vlefshëm në rastet kur rrezikohet thyerja e pritave të dajlanit për shkak të kushteve hidrometeorologjike.

Neni 6 Dajlanët

1. Dajlanët hapen për të mos funksionuar për peshkim në këto periudha të vitit:

- a) Dajlani i Shkodrës 15 mars deri më 31 gusht;
- b) Vilunit 15 mars deri më 30 shtator;
- c) Merxhanit 10 mars deri më 31 korrik;
- d) Cekës 10 mars deri më 31 korrik;
- e) Patokut 15 mars deri më 30 shtator;
- f) Karavastasë 5 mars deri më 5 maj;
- g) Nartës 10 shkurt deri më 10 prill;
- h) Orikumit 15 mars deri më 15 qershor;
- i) Butrintit 1 prill deri më 30 qershor;
- j) Prita e Rrezes 15 prill deri më 15 qershor.

2. Në periudhën kur dajlanët e lagunave bregdetare janë të hapur (sipas pikës 1 të këtij neni), ndalohet çdo formë peshkimi në laguna përveç grepave e parancave për ngjallën.

3. Ndalohet vendosja e kallamave (ose tubave plastikë, metalikë etj.) në dajlanët në një distancë më të vogël se 12 mm nga njëri-tjetri.

4. Ndalohet përdorimi i rrjetave (metalike, plastike etj.) me diametër më të vogël (të rrethit të brendashkruar në syza) se:

- a) 30 mm për dajlanin e Shkodrës;
- b) 28 mm për dajlanet e tjera.

Neni 7 Ndalimi për të peshkuar

1. Ndalohet peshkimi, mbajtja në bord, tranzitimi në barkë dhe zbarkimi i të gjitha llojeve të peshqve me çfarëdo lloj mjeti dhe metode gjuetie, në liqenet e Prespës së Madhe dhe Prespës së Vogël një muaj në vit. Data e fillimit të ndalimit të gjuetisë dhe mbarimit të saj përcaktohet me urdhër të veçantë të ministrit.

2. Ndalohet peshkimi, mbajtja në bord, tranzitimi në barkë dhe zbarkimi i të gjitha llojeve të peshqve me çfarëdo lloj mjeti dhe metode gjuetie, në liqenin e Ohrit nga 1 dhjetori deri më 31 dhjetor të çdo viti me përjashtim të tratave të zallit (vlag) për gjuetinë e cironkës.

3. Ndalohet përdorimi i rrjetave fundore ose i rrjetave notuese të fiksuara për peshkimin e specieve të mëposhtme: toni i bardhë (*Thunnus alalunga*), toni i kuq (*Thunnus thynnus*), peshku shtizë (*Xiphias gladius*), peshkaqenëve (*Hexanchus griseus*, *Cetorhinus maximus* *Alopiidae*; *Carcharhinidae*; *Sphyrnidae*; *Isuridae*; *Lamnidae*).

4. Ndalohet peshkimi me rrjeta fundore dhe draga tërheqëse në thellësi më të mëdha se 1000 metra.

5. Ndalohet përdorimi për peshkim dhe mbajtja në bord e pallangarëve me grepa, me gjatësi totale më të vogël se 10 cm dhe gjerësi më të vogël se 4.5 cm, për anijet e peshkimit që përdorin pallangarë dhe që

shkarkojnë ose kanë në bord një sasi peshku shtizë (*Xiphias gladius*) më të madhe se 10% të peshës së gjallë pas peshkimit.

6. Ndalohet përdorimi i njicave pelagjike (*driftnets*) për peshkimin e pelagjikëve të mëdhenj.

7. Ndalohet transbordimi në det i peshkut ton të peshkuar nga anijet e peshkimit.

8. Ndalohet zbarkimi i prodhimit të peshkut ton në porte të tjera, përveçse në portin e dizenuar dhe autorizuar nga Ministria.

9. Ndalohet zbarkimi i prodhimit të tonit nga anijet e peshkimit të tonit jashtë orareve të vendosura në autorizimin përkatës.

10. Ndalohet përdorimi i mjeteve të mëposhtme gjatë peshkimit në liqenin e Ohrit:

- a) rrjetë pezaul me saçme për cironkën në liqenin e Ohrit;
- b) fuzhnjë për krapin në liqen.

Neni 8 Ndalimet për disa forma dhe pajisje peshkimi

1. Ndalohet peshkimi me mjete dhe rrjetë tërheqëse fundore (koçe) në të gjitha kategoritë e ujërave të brendshme.

2. Ndalohet peshkimi me mjete tërheqëse në formë gabiesh, dragash etj., në ujërat të brendshme.

3. Ndalohet peshkimi tregtar industrial në ujërat e brendshme.

Neni 9 Sasitë maksimale ditore për molusqet bivalvore

1. Për çdo peshkatar profesionist të pajisur me leje për grumbullimin e molusqeve bivalvore në det e në laguna bregdetare, ndalohet tejkalimi në zëniet ditore, si më poshtë:

- a) biçaku *Solen* spp 10 kg;
- b) fazolari 50 kg;
- c) freskorja (kapesanta) *Pecten jacobaeus* 20 kg;
- d) midhja *Mytilus galloprovincialis* 80 kg;
- e) ostrea *Ostrea* spp. 30 kg;
- f) tartufi i detit *Venus verrucosa* 10 kg;
- g) telini *Donax trunculus* 50 kg;
- h) vongola *Venus gallina* 40 kg;
- i) vongola filipinase *Ruditapes semidecussatus* 40 kg;
- j) vongola verace *Ruditapes decussates* 10 kg.

2. Përcaktimi i sasive ditore maksimale të çdo subjekti do të bëhet në çdo leje/autorizim në vartësi të rezervës për çdo zonë.

3. Përjashtohen nga pikat 1 dhe 2 llojet që prodhohen nga impiantet e akuakulturës.

Neni 10

Karakteristikat e anijeve të peshkimit të molusqeve

Karakteristikat e anijes tip për peshkimin e molusqeve, numri i tyre, modeli i lejes, sasi të ditore të molusqeve, lloji i dragës etj., përcaktohen me rregullore të veçantë të ministrit.

Neni 11

Dimensionet minimale të rrjetave të peshkimit

1. Matja e dimensioneve të syzeve të rrjetave bëhet duke matur gjatësinë e syzes, pra distancën e brendshme midis dy nyjave përkundrejt njëra-tjetrës, e barabartë me dyfishin e një brinje të katërkëndëshit të syzes (2a). Matja bëhet me syze të tërhequr në aksin më të gjatë dhe me rrjetë të lagur e të përdorur.

2. Ndalohet mbajtja në bord e anijes së peshkimit dhe përdorimi i rrjetave me syze më të vogël se ato të paraqitura më poshtë:

- a) Tratë rrethimi:
 - për gjucën në liqenin e Shkodrës, të Fierzës dhe të Vaut të Dejës, 28 mm;
 - për gjucën (cironkën) në zonat e tjera, 20 mm.
 - b) Mrezha e njica:
 - në bregdet, 48 mm;
 - në laguna bregdetare, 60 mm;
 - për koranin në liqenin e Ohrit (statike ose notuese), 90 mm;
 - për belushkën në liqenin e Ohrit, 52 mm;
 - për krapin në liqenin e Shkodrës, 120 mm;
 - për krapin në liqenin e Ohrit e të Prespës dhe në ujërat e tjera, 66 mm;
 - për gjucën në liqenin e Shkodrës, të Fierzës dhe të Vaut të Dejës, 28 mm.
- Ndalohet bllokimi i syzeve të rrjetës në çdo pjesë të saj ose reduktimi faktik i dimensioneve të tyre.

KREU III KOMISIONET

Neni 12

Përbërja e Komisionit Konsultativ Qendror për Peshkimin dhe Akuakulturën

Përbërja e Komisionit Konsultativ Qendror për peshkimin dhe akuakulturën, si dhe mënyra e funksionimit të tij miratohet me rregullore të veçantë.

Neni 13

Përbërja e Komitetit për Koordinimin e Kërkimit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik (KKKSHTTE)

Përbërja e Komitetit për Koordinimin e Kërkimit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik (KKKSHTTE), si dhe mënyra e funksionimit të tij miratohet me rregullore të veçantë.

Neni 14

**Komisioni i Përhershëm i Ankimeve
Përbërja e Komisionit të Përhershëm të Ankimeve**

Komisioni i Përhershëm i Ankimeve, sipas nenit 131 të ligjit, kryesohet nga:

Zëvendësministri;

Anëtarët e tjerë të Komisionit përcaktohen në urdhrin përkatës të krijimit të tij.

Neni 15

Anëtarët e komisioneve të mësipërme emërohen me urdhrë të ministrit.

Neni 16

Anëtarë të ftuar në komisione

Kryetari i çdo komisioni të lartpërmendur mund të ftojë në mbledhjet e komisioneve funksionare të administratës ose ekspertë të veçantë në lidhje me problemet që shqyrtohen, në cilësinë e ekspertëve.

Neni 17

Procedura e gjykimit para Komisionit të Përhershëm të Ankimeve

1. Komisioni thërret, nëpërmjet lajmërimit me shkrim, personin që konsiderohet përgjegjës për kryerjen e një kundërvajtjeje administrative, mbi bazën e procesverbalit të paraqitur nga inspektori i peshkimit. Lajmërimi, së bashku me një kopje të procesverbalit, duhet t'i dërgohet personit në fjalë, të paktën 1 javë para mbledhjes së Komisionit.

2. Në lajmërim tregohen vendi, data dhe ora e mbledhjes së komisionit për shqyrtimin e kundërvajtjes në fjalë.

3. Komisioni mund të procedojë për gjykim në datën, vendin dhe orën e caktuar:

a) Nëse personi i konsideruar përgjegjës nuk gjendet;

b) Në mungesë të personit të konsideruar përgjegjës për kundërvajtjen vetëm atëherë kur rezulton se personi në fjalë ka marrë dijëni, si dhe kur nuk ka asnjë shkak të arsyeshëm për mosparaqitjen;

c) Nëse personi i konsideruar përgjegjës për kundërvajtjen ka autorizuar me prokurë të noterizuar një person tjetër për ta përfaqësuar.

4. Komisioni thërret, gjithashtu, në të njëjtën datë dhe orë inspektorin e peshkimit që ka bërë procesverbalin.

5. Në gjykim duhet t'i jepet mundësia të dëgjohet, kur është i pranishëm, edhe personit të konsideruar përgjegjës për kryerjen e kundërvajtjes.

6. Sekretari i komisionit mban procesverbalin e zhvillimit të mbledhjes, si dhe rezultatit e votimit për vendimin. Procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët e Komisionit.

7. Komisioni merr një vendim të motivuar në fund të gjykimit. Vendimi bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga kryetari i komisionit.

8. Vendimi i komunikohet të interesuarit, me shkrim.

Neni 18

Asgjësimi i mjeteve dhe veglave të sekuestruara

1. Me urdhër ministri, rast pas rasti, ngrihet një komision asgjësimi i mjeteve dhe i veglave të peshkimit të sekuestruara dhe të konfiskuara (nga vendimi i Komisionit të Përhershëm të Shqyrtimit të Ankimimeve). Çdo asgjësim i këtij Komisioni (të posaçëm) bëhet me procesverbal ku firmos çdo anëtar i Komisionit, i cili mbahet në dy kopje; një kopje i dorëzohet Komisionit të Përhershëm të Ankesave, një kopje e mban inspektori i peshkimit të rajonit përkatës.

2. Mjetet dhe veglat e peshkimit, sipas pikës 1 të mësipërme, janë ato mjete, të cilat janë të ndaluara nga ligji dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Neni 19

Në bazë të nenit 44 të ligjit, kundër vendimit të Komisionit bëhet ankim në gjykatë.

Neni 20

KREU III

PLANET E MENAXHIMIT DHE PLANET E ZBATIMIT TË PESHKIMIT

1. Ministria miraton çdo 5 vjet plane menaxhimi dhe plane zbatimi peshkimi, për peshkimin në detet Adriatik dhe Jon. Këto plane mund të përfshijnë veçanërisht:

a) Objektiva afatshkurtër, afatmesëm të zhvillimit të peshkimit;

b) Masa të menaxhimit të sforcos së peshkimit;

c) Masa të veçanta teknike, përfshirë, aty ku mendohet e nevojshme dhe përjashtime të përkohshme nga dispozitat e kësaj rregulloreje, aty ku këto përjashtime janë të nevojshme për kryerjen e aktivitetit të peshkimit, me kusht, që ky plan menaxhimi të garantojë shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve të marra në konsideratë;

d) Shtrirjen si përdorim të detyrueshëm të sistemit të kontrollit me anë të satelitit VMS apo të sistemeve të ngjashme për anijet e peshkimit me gjatësi të përgjithshme 12 metra;

e) Kufizime të përkohshme apo të përhershme në disa zona, të rezervuara për disa lloj mjeteve peshkimi apo anijesh, që kanë nënshkruar detyrimet në kuadrin e planit të menaxhimit;

f) Planet e menaxhimit parashikojnë lëshimin e lejeve të veçanta të peshkimit, anijeve të peshkimit me gjatësi të përgjithshme më të vogël se 10 metra.

3. Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, Komisioni Konsultativ Qendror për Peshkimin dhe Akuakulturën jep sugjerime në lidhje me përcaktimin e planeve të menaxhimit.

4. Ministria kryen një monitorim të përshtatshëm shkencor të planeve të menaxhimit, si dhe rishikon çdo vit, në veçanti, disa masa menaxhuese në lidhje me aktivitetet e peshkimit, që shfrytëzojnë llojet me cikël të shkurtër jetësor, për të pasur parasysh ndryshimet e mundshme në aftësinë e rekrutimit.

5. Ministria miraton plane menaxhimi për aktivitetet e peshkimit, të kryera me trata, trata zalli, trata krahu bregdetare, rrjeta me rrethim dhe daga për zona të caktuara të bregdetit, brenda datës 31 dhjetor 2014.

6. Ministria mund të hartojë plane të tjera menaxhimi, bazuar mbi të dhëna të reja të rëndësishme shkencore, edhe në një kohë të dytë.

7. Planet e menaxhimit, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, mund të përfshijnë dhe masa që shkojnë përtej dispozitave të kësaj rregulloreje, me qëllim:

a) Rritjen e selektivitetit të mjeteve të peshkimit;

b) Reduktimin e hedhurinave në det;

c) Kufizimin e sforcos së peshkimit.

8. Masat që përfshihen në planet e menaxhimit janë në përpjesëtim me qëllimet, objektivat dhe afatet e parashikuara dhe duhet të mbajnë parasysh faktorët e mëposhtëm:

a) Gjendjen e ruajtjes së rezervës apo rezervave;

b) Karakteristikat biologjike të rezervës apo rezervave;

c) Karakteristikat e aktiviteteve të peshkimit, i cili peshkon këtë rezervë;

d) Impaktin ekonomik të këtyre masave, në aktivitetin e peshkimit që preket nga to.

KREU V

REGJISTRI I PESHKATARËVE PROFESIONISTË DHE REGJISTRI KOMBËTAR I MJETEVE LUNDRUESE TË PESHKIMIT

Neni 21

Mbajtja dhe forma e Regjistrit

1. Regjistri i peshkatarëve profesionistë mbahet në drejtorinë përgjegjëse për peshkimin dhe në Organizatën e Menaxhimit të Peshkimit nga menaxheri i saj. Zyrat e Inspektoratit të Peshkimit mbajnë regjistrin përkatës për personat që mbulojnë.

2. Regjistri i peshkatarëve profesionistë mbahet i ndarë në dy pjesë:

a) Për peshkatarët që ushtrojnë peshkimin detar në anijet e peshkimit me kuvertë;

b) Për peshkatarët që ushtrojnë peshkimin me mjete lundruese pa kuvertë në bregdet e ujëra të brendshme ose pa mjete lundruese.

3. Në Regjistër shënohen për çdo person të regjistruar dënimet eventuale që mund të jenë dhënë për shkelje të ligjit e akteve nënligjore të peshkimit.

Neni 22

Kërkesa për regjistrim

1. Kërkesa për regjistrim në Regjistrin e Peshkatarëve Profesionistë bëhet nga kërkuesi dhe paraqitet në drejtorinë e politikave që mbulon peshkimin, e kompletuar dhe e shoqëruar me dy fotografi e me dokumentet përkatëse, që kërkohen nga drejtoria përkatëse.

2. Drejtoria verifikon kompletimin e kërkesës në konformitet me kushtet e përcaktuara nga ligjet e rregulloret e peshkimit dhe miraton regjistrimin.

Neni 23

Regjistrimi

1. Në Regjistër kanë të drejtë të regjistrohen peshkatarët që punojnë në peshkim për një periudhë më shumë se 3-vjeçare pa shpëputje edhe në rastin kur nuk plotësojnë kriteret e tjera për regjistrim.

2. Për peshkatarët e tjerë që kërkojnë të punojnë si profesionistë, regjistrimi është kusht i domosdoshëm dhe bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara në nenin 33 të kësaj rregulloreje.

Neni 24

Kushtet për regjistrim

Për të fituar të drejtën e regjistrimit në Regjistrin e Peshkatarëve Profesionistë, është e nevojshme që personi kërkues:

- Të ushtrojë peshkimin profesional si aktivitet i vetëm i përhershëm ose sezonal punësimi;
- Të jetë rezident në Republikën e Shqipërisë;
- Përveç rastit të parashikuar në pikën 1 të nenit 32 të kësaj rregulloreje, të ketë dëshminë e kualifikimit si peshkatar;
- Të mos ketë pësuar asnjë dënim penal për shkelje të ligjit të peshkimit dhe jo më shumë se tri dënime për kundërvajtje administrative të ligjit dhe të akteve nënligjore për peshkimin.

Neni 25

Dokumenti i regjistrimit

1. Regjistrimi i jep të drejtën e pajisjes me dokumentin e regjistrimit si peshkatar profesionist.

2. Dokumenti i regjistrimit është i domosdoshëm për çdo person që punon në sektorin e peshkimit. Ky dokument mbahet nga çdo punonjës dhe i vihet në dispozicion, në rast se kërkohet, nga një inspektor peshkimi.

3. Dokumenti i regjistrimit lëshohet me firmën e titullarit.

Neni 26

Kohëzgjatja e regjistrimit

Regjistrimi në Regjistrin e Peshkatarëve Profesionistë bëhet për një afat të pakufizuar.

Neni 27

Çregjistrimi nga Regjistri i Peshkatarëve Profesionistë

1. Titullari vendos për çregjistrimin nga Regjistri i Peshkatarëve Profesionistë:

- Në rastin kur vdes i regjistruari;
- Në rastet kur Organizata e Menaxhimit të Peshkimit, ku bën pjesë peshkatarin, e ka përjashtuar atë për mosushtim të veprimtarisë së peshkimit në përputhje me statutin e OMP-së;
- Në rastet e ndërprerjes së aktivitetit të peshkimit për një periudhë mbi tre vjeçare;
- Në bazë të kërkesës së personit të regjistruar kur ndërpret aktivitetin e peshkimit (për shkak sëmundje, dëmtimi fizik etj.);
- Në rastet kur vërehen shkelje të ligjit, mbi bazën e kërkesës së një inspektori të peshkimit;
- Në rastet kur ka dënim penal për shkelje të ligjit të peshkimit dhe kalon 3 (tri) dënime për kundërvajtje administrative të ligjit dhe të akteve nënligjore për peshkimin.

2. Në rastet e çregjistrimit, personi i regjistruar është i detyruar të dorëzojë në drejtori dokumentin e regjistrimit.

Neni 28

Kualifikimi profesional

1. Ministria mund të specifikojë kërkesat dhe kriteret për kualifikimin profesional në lidhje me veprimtarinë e peshkimit, të akuakulturës ose të veprimtarive të lidhura me peshkimin.

2. Kualifikimi profesional i të regjistruarit shënohet në Regjistrin e Peshkatarëve Profesionistë.

3. Drejtoria mban regjistër të veçantë në bazë të kualifikimit profesional të të regjistruarve.

4. Ministria, në bashkëpunim me organizatat e peshkimit, sipas pikës 1 të nenit 58 të ligjit nr. 64/2012, organizon kualifikimin/edukimin e peshkatarëve me normat ligjore të ushtrimit të aktivitetit të peshkimit, për të cilin jep dëshmitë përkatëse.

Neni 29

Regjistri Kombëtar i Mjeteve Lundruese të Peshkimit

1. Drejtoria e politikave, që mbulon fushën e peshkimit, krijon dhe mban Regjistrin Kombëtar të Mjeteve Lundruese, ose Regjistri i Anijeve të

Peshkimit, që ushtrojnë peshkim tregtar, në format elektronik (RAP). Regjistri lokal i mjeteve lundruese të peshkimit mbahet dhe në zyrat e inspektorateve në rrethe.

2. Zotërimi i mjeteve lundruese, që përdoren për peshkim tregtar, nuk përbën kusht të mjaftueshëm për të fituar të drejtën e pajisjes me leje të peshkimit tregtar.

3. Në Regjistrin e Mjeteve të Lundrimit me kuvertë shënohen të dhënat për identifikimin e mjetit lundrues, të dhënat teknike të mjetit dhe të pajisjeve të peshkimit dhe ngjarjet/dënimet eventuale.

4. Përfshihet nga pika 1 e këtij neni mjeti lundrues, pronari i mjetit, ose përdoruesi i tij, që është regjistruar në listën e zezë të anijeve që zhvillojnë aktivitet PPP – peshkim i paligjshëm i parregulluar (IUU) të BE-së apo të ndonjë organizate ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë, si: FAO-GFCM, ICCAT.

Neni 30 Regjistrimi

1. Regjistrimi në regjistrin e mjeteve lundruese të peshkimit bëhet pas lëshimit të aktit përkatës të miratimit të peshkimit. Mjetet që nuk janë pajisur me leje peshkimi nuk regjistrohen në këtë regjistrë.

2. Çdo mjet lundrues i peshkimit pajiset me një numër regjistri NFR (CFR), që nuk ndryshon në rastet e rinovimit të licencës së peshkimit. Numri i regjistrit “NFR-CFR” bën qartësisht identifikimin e një anije peshkimi. Ky numër jepet në mënyrë përfundimtare në momentin në të cilin anija regjistrohet për herë të parë në regjistrin kombëtar. Ajo nuk mund të modifikohet ose t’i jepet një anijeje tjetër.

3. Një kopje e regjistrit të anijeve të peshkimit i dërgohet çdo vit Sekretariatit të KPPM-së (GFCM) në format elektronik.

4. Nga ana e Inspektoratit të Peshkimit mbahet një regjistrë i veçantë për dënimet eventuale që mund të jenë dhënë për shkelje të ligjit e të akteve nënligjore të peshkimit, e cila bëhet disponibël sa herë mblidhet bordi i licencave dhe Komisioni i Përhershëm i Ankimeve për Peshkimin dhe Akuakulturën.

KREU VI LEJET E PESHKIMIT

Neni 31 Bordi/Komisioni i lejeve

Bordi/Komisioni i lejeve përbëhet nga një numër minimal prej 5 ose 7 anëtarësh, në përbërje të të cilit janë specialistë të peshkimit, një jurist dhe kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Politikave për Peshkimin. Përbërja e tij miratohet me urdhër të veçantë të ministrit.

1288

Neni 32

Aplikimi dhe kërkesat për leje peshkimi në det

1. Aplikimi bëhet pranë QKL-së për format e peshkimit, që janë të parashikuara për t’u pajisur me leje.

2. Lejet e peshkimit lëshohen po nga QKL-ja pas shqyrtimit, verifikimit për plotësimin e kriterëve të lejimit dhe përgatitjes së dokumentit tip (leja) nga Drejtoria në ministrinë që mbulon peshkimin. Vendimi merret nga (Bordi/Komisioni) dhe bazohet në vlerësimin e dokumentave të paraqitura në aplikim:

i) Për mjetin lundrues me kuvertë:

a) dëshmi pronësie (nga Kapiteneria e Porteve);

b) dëshmi flamuri (nga Kapiteneria e Porteve);

c) certifikatë lundrimi (nga Regjistri Detar);

d) certifikatë regjistrimi dhe ekstrakti historik nga QKR-ja.

ii) Për mjetin lundrues pa kuvertë (për peshkim artizanal):

a) libri i mjetit lundrues (nga Kapiteneria e Porteve);

b) dokumenti i Regjistrit të Mjetit Lundrues (nga Policia Kufitare) ose vërtetim aplikimi pranë saj;

c) certifikatë regjistrimi dhe ekstrakti historik nga QKR-ja.

1. Bordi/Komisioni shqyrton kërkesat e paraqitura, merr vendimin përkatës, të firmosur nga çdo anëtar, harton lejen tip dhe/ose aktin e refuzimit, të cilat firmosen nga titullari i Ministrisë dhe ia kalon QKL-së për komunikim me aplikantin.

Neni 33

Vlefshmëria e licencave të peshkimit

Lejet e peshkimit kanë vlefshmëri si më poshtë:

1. Në peshkimin detar, që ushtrohet me mjete lundruese me kuvertë (motobarka ose anije peshkimi), leja ka vlefshmëri 5 vjet.

2. Në peshkimin bregdetar, që ushtrohet me mjete lundruese pa kuvertë (sanalle, lundra etj., me ose pa motor), leja ka vlefshmëri deri në 5 vjet.

Neni 34

Disponibiliteti i lejeve dhe dublikatat

1. Leja e peshkimit, së bashku me aktin e miratimit, të lëshuar në bazë të ligjit dhe kësaj rregulloreje, është dokumenti bazë për ushtrimin e peshkimit tregtar dhe mbahet në çdo moment në bordin e anijes.

2. Në rast se leja humbet ose bëhet e palexueshme, QKL-ja i lëshon mbajtësit të saj një duplikatë, mbi bazën e një konfirmimi të firmosur nga ministri.

Neni 35

Ndërprerja e lejes/kontratës

1. Ndërprerja e vlefshmërisë së lejes është kompetencë e inspektorëve të peshkimit, si dhe Komisionit të Shqyrtimit të Përhershëm të Ankimeve (KPSHA).

2. Vendimi i KPSHA-së për ndërprerjen e lejes dërgohet në QKL, e cila bën ndërprerjen e saj.

3. Vendimi i KPSHA-së për ndërprerjen e lejes/kontratës i njoftohet me shkrim subjektit të lejes/kontratës.

4. Zotëuesi i lejes është i detyruar të dorëzojë pranë inspektorit të peshkimit ose zyrës së Inspektoratit të Peshkimit, në rrethin përkatës, dokumentin e lejes deri në vendimin e KPSHA-së dhe sanksioneve plotësuese.

Neni 36

Anulimi i lejes

1. Leja humbet vlefshmërinë në mënyrë të përkohshme:

a) Kur subjektit fizik ose juridik i ndalohet të zhvillojë aktivitetin e peshkimit dhe të akuakulturës nga vendimi i KPSHA-së;

b) Në rastet kur subjekti fizik ose juridik kryen shkelje të parashikuara në nenin 117 të ligjit;

c) Kur subjekti fizik ose juridik nuk paguan taksën vjetore të lejes, brenda datës 31 mars të vitit në vazhdim.

2. Leja ose kontrata humbet vlefshmërinë në mënyrë të përhershme, kur:

a) Përfundon ose mbyllet veprimtaria e peshkimit profesional;

b) Zotëuesi i saj nuk dëshiron të vazhdojë veprimtarinë e peshkimit të lejuar nëpërmjet kësaj lejeje;

c) Kur subjekti fizik ose juridik nuk paguan gjobat e vendosura për shkeljet e konstatuara në bazë të neneve 117 dhe 128 të ligjit;

d) Kur subjekti fizik ose juridik është dënuar dy herë nga KPSHA-ja;

e) Kur subjekti fizik ose juridik, i ndodhur në kushtet e germës “c” të pikës 1 të këtij neni, nuk e paguan taksën vjetore të lejes deri në datën 30 prill të po atij viti;

f) Në rast se një mjet lundrues nuk përdoret për zhvillimin e veprimtarisë për të cilën është marrë leje, për një periudhë më shumë se gjashtë muaj. Inspektori i peshkimit bën verifikimin dhe paraqet procesverbalin përkatës të titullari i DSHPA-së;

g) Në rast të moszbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga kushtet e lejes.

3. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen edhe në rastin e lejeve apo të licencave në fuqi, të lëshuara përpara miratimit të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”.

Neni 37

Kushtet për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit

1. Çdo subjekt peshkimi është i detyruar të respektojë detyrimet si më poshtë:

a) Të zbatojë aktet ligjore dhe nënligjore për peshkimin;

b) Të zbatojë me përpikëri Rregulloren e Menaxhimit të Portit ose Qendrës së Peshkimit;

c) Subjekti i peshkimit duhet të ketë me vete në bordin e anijes lejen e peshkimit, e cila është e vlefshme vetëm për një mjet lundrimi/anije peshkimi;

d) Të zbatojë me korrektesë specifikimet e parashikuara në lejen/kontratën e tij të peshkimit;

e) T’i bindet me korrektesë çdo urdhri të marrë nga një inspektor peshkimi, siç janë lejimi i inspektimit ose çuarja e motobarkës pranë një porti ose moli peshkimi;

f) Kapitenët e anijeve, që peshkojnë lloje që i përkasin një resursi ose grup resursesh, janë të detyruar të mbajnë një libër ose ditar të anijes ku të regjistrojnë me rregull e në mënyrë të lexueshme të dhënat në lidhje me sasitë e peshkuara, dhe që janë në bordin e anijes, datën dhe vendin e këtyre zënieve, si dhe llojin e rrjetës së përdorur dhe t’i paraqesin ato sa herë që i kërkohen nga inspektorët e peshkimit; në rastin e licencave të lëshuara për disa mjete lundruese, ky detyrim duhet të përmbyset nga titullari i licencës;

g) Subjektet e tjera të peshkimit duhet të mbajnë regjistrat e prodhimit dhe të regjistrojnë të dhënat mbi aktivitetin e peshkimit;

h) Të lejojnë hyrjen dhe qëndrimin në bordin e anijes të inspektorëve të peshkimit, të vrojtuesve dhe të punonjësve shkencorë e teknikë të vendit ose të huaj, kur janë të autorizuar nga ministri, si dhe të mundësojnë përmbyshjen e misionit të tyre;

i) Kapiteni i anijes dhe subjekti i peshkimit duhet të respektojë kufizimet në lidhje me zbarkimet e prodhimit, veprimtarinë e peshkimit, mjeteve të peshkimit, rrjetave dhe identifikimin dhe anijeve dhe targat e sanalleve të peshkimit.

2. Ndalohet dhënia e lejes së peshkimit tregtar mjeteve lundruese/anijeve të peshkimit me flamur të huaj.

3. Numri maksimal i lejeve të peshkimit tregtar përcaktohet nga ministri në zbatim të planit të menaxhimit të peshkimit.

4. Leja e peshkimit tregtar ka kohëzgjatje të caktuar, e treguar qartë në leje.

5. Ndalohet të zhvillohet çfarëdolloj aktiviteti peshkimi, në qoftë se nuk respektohen kushtet sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 38

Autorizimet

Llojet e autorizimeve

1. Autorizimi për peshkimin amator janë autorizimet që u jepen individëve vendas dhe/ose të huaj, dhe lëshohen mbi bazën e planifikimit vjetor nga Ministria së bashku me kriteret. Autorizimi amator mund të jetë afatgjatë ose afatshkurtër.

2. Autorizimi për peshkimin turistik është vetëm afatshkurtër, jo më shumë se 30-ditë.

3. Autorizimi për qëllime të kërkimit shkencor u lëshohet enteve kërkimore-shkencore në bazë të kualifikimit, certifikimit dhe kapacitetit të tyre.

4. Autorizimi për peshkim jashtë ujërave territoriale të Shqipërisë i lëshohet një anije peshkimi që kërkon të peshkojë në këto ujëra; ky autorizim mund të jetë pjesë e lejes së peshkimit.

5. Autorizimi për aktivitete specifike peshkimi subjekt i rregullave të veçanta dhe kufizimeve.

6. Autorizimi për aktivitete në të cilin zbatohet një plan shumëvjeçar peshkimi.

7. Autorizimi sipas pikës 3, lëshohet nga ministri për të cilët kërkohet paraprakisht mendimi i Komitetit për Koordinimin e Kërkimit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik (KKKSHTe).

Neni 39

Rregullimi i sforcos së peshkimit

1. Ministria përcakton kufijtë minimalë dhe maksimalë për zonat subjekt i një sforcë peshkimi, rregullat e komunikimit dhe të autorizimit të anijeve të peshkimit, subjekt i kësaj sforcë.

2. Anijet e peshkimit, që janë të lidhura me një sforcë peshkimi (të autorizuar për shfrytëzimin e një kuote/apo ka peshkuar në një zonë me sforcë peshkimi) janë të detyruara:

a) Të mbajnë të regjistruara të gjitha të dhënat në librat e anijes, deklaratat e shitjes dhe/ose të transbordimit;

b) Të raportojnë tek Inspektorati i Peshkimit, brenda datës 25 të çdo muaji, për sasitë e peshkuara dhe të zbarkuara të çdo stoku/grup stoku, subjekt i kuotave totale të lejuara (TAC);

c) Kapiteni ose pronari i anijes së peshkimit, kur është objekt i një sforcë të caktuar në lidhje me veglat apo numrin e tyre në një zonë gjeografike të caktuar, është i detyruar të lajmërojë Inspektoratin e Peshkimit për veglat e peshkimit dhe sasinë e tyre në bord.

Neni 40

Portet dhe qendrat e peshkimit

1. Zëniet e kryera me trata koçe, rrjeta të tërhequra pelagjike, koshilok, parangallë, duhet të zbarkohen dhe të tregtohen për herë të parë në vendzbarkimet e

porteve të peshkimit në Shëngjin, Durrës, Vlorë dhe Sarandë.

2. Zëniet e kryera me rrjeta, grepa në liqenet e Shkodrës, Ohrit dhe Prespës së Madhe dhe të Vogël, në liqenet e Fierzës dhe të Ulzës, duhet të zbarkohen dhe të tregtohen për herë të parë në qendra të miratuara nga autoritetet kompetente veterinarë.

3. Për kontrollimin e sasive maksimale të peshkuara nga anijet, molusqet bivalvore duhet të zbarkohen brenda një orari të përcaktuar dhe në një pikë të vetme zbarkimi, të përcaktuar për çdo port me urdhër të veçantë të DSHPA-së.

4. Për subjektet e tjera, pikat e grumbullimit të molusqeve bivalvore, do të përcaktohen me urdhër të veçantë të Drejtorisë së Politikave që mbulon fushën e peshkimit.

5. Porti i zbarkimit dhe oraret e zbarkimit të tonit të kuq të Atlantikut, nga subjektet e autorizuar për peshkimin e kuotës së tonit (përcaktuar çdo vit nga ICCAT), do të jetë pjesë e autorizimit lëshuar nga ministri.

KREU IV

KËRKIMI SHKENCOR

Neni 41

Ministria mbështet programet për vlerësimin e burimeve të sektorit dhe të situatës ekonomike, nëpërmjet:

a) Grumbullimit të të dhënave biologjike, që përfshijnë të gjitha resurset peshkore, përfshirë edhe hedhurinat;

b) Vlerësimit të rezervës peshkore për një strukturë burimesh peshkore, pavarësisht nga peshkimi industrial;

c) Grumbullimit të informacionit mbi kapacitetet e zënieve dhe sforcos së peshkimit të përdorur;

d) Vlerësimit të akuakulturës e monitorimit të vazhdueshëm të saj për një zhvillim të përgjegjshëm;

e) Vlerësimit të aspekteve ekonomike e sociale në sektorët e peshkimit dhe të akuakulturës;

f) Interpretimit të të dhënave mbi çmimet e vendosura dhe të aftësisë së situatës ekonomike të ndërmarrjeve të peshkimit dhe të industrisë përpunuese, të marra në vëzhgim, në mënyrë sa më të mirë, për sektorët e peshkimit.

Neni 42

Autorizimi për kërkimin

1. Autorizimi për kërkimin përgatitet nga Drejtoria e Politikave që mbulon peshkimin dhe lëshohet me firmën e ministrit.

2. Autorizimi mund t'u lëshohet enteve kërkimore, të njohura në bazë të kësaj rregulloreje dhe institucioneve të tjera kërkimore të vendit ose të huaja,

të certifikuara, që plotësojnë kriteret e një enti kërkimor, sipas nenit 47 të kësaj rregulloreje.

3. Kohëzgjatja e një autorizimi për kërkimin përcaktohet në dokumentin që lëshohet për këtë qëllim.

Neni 43

Njohja e entit të kërkimit

1. Njohja e entit të kërkimit bëhet me vendim të ministrit mbi bazën e vendimit të Komisionit për Koordinimin e Kërkimit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik (KKKSHTË), të certifikimit të entit të kërkimit nga institucionet certifikuese.

2. Njohja e entit të kërkimit bëhet për një kohë të kufizuar, në vartësi të aktiviteteve në fushën e peshkimit që ai ent merr përsipër. Ajo mund të anulohet në rastet kur nuk respektohen dispozitat e neneve të kësaj rregulloreje, si dhe në rastet kur vërehen shkelje të ligjit dhe akteve të tjera nënligjore.

Neni 44

Kërkesat për njohjen e enteve të kërkimit

Për të fituar të drejtën e entit, të njohur për kërkime në peshkim dhe në akuakulturë, është e nevojshme:

- a) Vendimi i gjykatës për personalitetin juridik;
- b) Certifikimin e duhur për kryerjen e kërkimit shkencor në peshkim dhe në akuakulturë;
- c) Të disponojë personel me arsim të lartë, kualifikime shkencore, ekspertë në disiplina të peshkimit dhe të akuakulturës;
- d) Të disponojë mjetet financiare dhe pajisjet për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore përkatëse;
- e) Të jetë i certifikuar në nivel akademik për kapacitetet e tij në fushën e kërkimit dhe të përpunimit të informacioneve shkencore të peshkimit ose të akuakulturës.

Neni 45

Detyrimet e entit të njohur të kërkimit

1. Çdo ent i njohur kërkimi është i detyruar të paraqesë në Drejtorinë e Politikave që mbulon peshkimin:

- a) Emrin dhe adresën e entit të regjistruar;
- b) Certifikatë që e njeh si ent kërkimor shkencor;
- c) Objektin e veprimtarisë së entit sipas regjistrimit në gjykatë si person juridik privat ose shtetëror;
- d) Emrat e ekspertëve të autorizuar të entit, si: presidentin, anëtarët e bordit etj.;
- e) Kërkimet ose projektet që ka zhvilluar si ent ose në bashkëpunim;
- f) Kërkesa për njohjen si ent, duke specifikuar llojin e kërkimeve që kërkon të zhvillojë.

2. Çdo ent i njohur kërkimi është i detyruar t'i lëshojë një autorizim personit që punon për llogari të atij enti.

3. Gjatë kërkimit të kryer dhe në përfundim të tij, çdo ent i njohur detyrohet të paraqesë relacionin përkatës në Drejtorinë e Politikave që mbulon peshkimin dhe të japin në çdo moment të dhënat që iu kërkohen në lidhje me veprimtaritë kërkimore të zhvilluara.

4. Gjatë veprimtarisë së tij, çdo ent kërkimor mbikëqyret nga personi përgjegjës i caktuar nga Drejtoria e Politikave që mbulon peshkimin.

KREU XII

INSPEKTIMI DHE KONTROLLI I AKTIVITETIT TË PESHKIMIT

Neni 46

Autoriteti i Inspektimit të Peshkimit është pjesë e strukturës së Ministrisë

Neni 47

Misioni i inspektorëve të peshkimit

Misioni i Inspektoratit të Peshkimit është inspektimi, kontrolli i veprimtarive të peshkimit. Më pas, harton procesverbalin e shkeljes së konstatuar në peshkim dhe në akuakulturë. Ai/ajo përpilon procesverbalin në 3 kopje, ku një kopje ia dorëzon personit të gjetur me shkelje ligjore të fushës së peshkimit dhe të akuakulturës, një kopje e dërgon në drejtorinë që mbulon peshkimin në Ministri, një kopje e arshivon në dokumentacionin e tij. Vendimi final merret nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në Ministri.

Neni 48

Identifikimi i inspektorëve të peshkimit

Inspektorët e peshkimit pajisen me dokumentin përkatës të identifikimit, të lëshuar nga Ministria me firmën e ministrit, të cilën e mbajnë gjatë ushtrimit të funksioneve inspektuese. Inspektorët tregojnë dokumentin e tyre të identitetit çdo personi që inspektojnë gjatë kryerjes së detyrës së tyre funksionale.

Neni 49

Objekti i kontrollit

1. Për të garantuar respektimin e të gjithë legjislationit në fuqi, Inspektorati i Peshkimit kontrollon aktivitetin e peshkimit, të akuakulturës dhe të aktiviteteve të lidhura me të, në ujërat detare territoriale dhe në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Anijet e peshkimit dhe të gjitha aktivitetet me qëllim zbatimin e legjislationit të peshkimit, si dhe aktivitetet e zbarkimit, shitjes, transportit dhe magazinimit të produkteve të peshkut, si dhe regjistrimin e zbarkimeve dhe shitjeve.

3. Kontrolli i shitjes së parë, të transportit dhe të magazinimit të peshkut, në lidhje me dimensionet e peshkut dhe të zonës gjeografike të zënies së tij.

4. Verifikimi i nivelit të kapacitetit të peshkimit, të fuqive motorike të certifikuara paraprakisht të anijeve të peshkimit.

5. Aktiviteti i peshkimit të anijeve të peshkimit jashtë ujërave territoriale, kur kjo është e nevojshme për të garantuar respektimin e rregullave ndërkombëtare për peshkimin.

Neni 50 Inspektimi

1. Në zbatim të nenit 122 dhe 123 të ligjit Inspektorati i Peshkimit zhvillon aktivitetin e tij të kontrollit në mënyrë të tillë që të mos pengojë zhvillimin normal të aktivitetit të peshkimit të subjektit. Ata, gjithashtu, zhvillojnë aktivitetin e kontrollit pa asnjë diskriminim në përzgjedhjen e subjekteve dhe të sektorëve që kontrollojnë.

2. Inspektorët e peshkimit para fillimit të inspektimit, duhet të përgatisin dhe t'i dorëzojnë titullarit të licencës një dokument mbi të gjitha aktivitetet që do të jenë objekt kontrolli.

3. Inspektorët e peshkimit, në përfundim të kontrollit duhet të përgatisin një relacion mbi rezultatet e kontrollit dhe një kopje dorëzohet në drejtori. Në rast se konstatohen shkelje dhe vendosen sanksione, një kopje dërgohet në drejtorinë përgjegjëse për peshkimin.

4. Titullarët e lejeve, ambienteve, qendrave të grumbullimit të peshkut ose mjeteve të transportit, objekt kontrolli, bashkëpunojnë me Inspektoratin me qëllim lehtësimin e kontrollit.

Neni 51 Kontrolli i përdorimit të veglave të peshkimit

1. Rrjetat e peshkimit, të mbajtura në bordin e anijes së peshkimit dhe që nuk janë objekt i lejuar i përdorimit për peshkim, duhet të jenë të sistemuara, të lidhura e të bllokuara në mënyrë të tillë që të mos jenë lehtësisht të përdorshme, duke zbatuar kushtet e mëposhtme:

a) Rrjetat, peshat dhe pajisjet e ngjashme janë të stakuara nga panelet e tyre, ashtu sikurse nga kavot dhe litarët e tërheqjes;

b) Rrjetat që mbahen në urën e anijes janë të lidhura mirë me strukturën mbështetëse.

2. Në qoftë se zëniet që janë në bord të një anijeje peshkimi janë kryer me vegla me dimensione minimale të ndryshme gjatë të njëjtës dalje në det, përbërja e specieve llogaritet për çdo pjesë, të sasisë që është kapur në kushte të ndryshme. Për këtë qëllim, çfarëdolloj ndryshimi i dimensioneve të syzeve të rrjetave, të përdorura më parë, si dhe përbërja e peshkut të peshkuar i pranishëm në bord, në momentin e ndërrimit të rrjetave regjistrohet në ditarin e anijes dhe të deklarimit të zbarkimit.

3. Drejtoria mund të vendosë që në zona të caktuara peshkimi, të mos përdoren rrjeta me dimensione minimale, të ndryshme nga një anije peshkimi, gjatë së njëjtës dalje në det.

Neni 52 Rregullimi dhe mbyllja e aktivitetit të peshkimit

1. Ministri vendos mbylljen e peshkimit në një zonë dhe për një periudhë kohe të caktuar kur zëniet e një stoku apo grup stoqesh, objekt kuotë të peshkueshme janë ezauruar.

2. Të gjitha sasitë e peshkut që i përkasin një resursi ose grup resursesh, objekt kuotash të peshkueshme nga anijet e peshkimit, llogariten mbi bazën e kësaj kuote, për resursin ose grupin e resurseve, pavarësisht nga vendi i zbarkimit.

3. Ministria përcakton datën në të cilën vlerëson se zëniet e peshkut të një resursi ose grup resursesh, objekt kuote, të kryera nga anijet e peshkimit me flamurin esaj ose që zhvillojnë aktivitet në ujërat territoriale të Republikës së Shqipërisë, e kanë ezauruar kuotën për këtë resurs ose grup resursesh. Duke filluar nga kjo datë, Ministria u ndalon përkohësisht anijeve të peshkimit të peshkojnë atë resurs ose grup resursesh, sikurse mbajtjen në bord, transbordimin dhe zbarkimin në rast se këto sasi janë peshkuar pas kësaj date.

4. Ministria përcakton një datë brenda së cilës lejohet zbarkimi, transbordimi dhe deklaratat e fundit në lidhje me zëniet.

5. Anijet e peshkimit, ndalojnë peshkimin e specieve që bën pjesë në atë resurs ose grup resursesh, objekt kuotash, në datën e vlerësuar se kuota është ezauruar. Këto anije, gjithashtu, nuk mbajnë në bord, transbordojnë ose zbarkojnë zëniet e këtyre resurseve ose grup resursesh, të peshkuara pas kësaj date.

6. Ministria përcakton një datë në të cilën vlerëson se anijet që mbajnë flamurin e saj ose të regjistruara në territorin e saj kanë arritur sforcon maksimale të peshkimit për një zonë të caktuar. Ajo u ndalon përkohësisht aktivitetin e peshkimit anijeve, duke filluar nga kjo datë për këtë zonë peshkimi.

Neni 53 Inspektimi dhe kontrolli i ndryshimeve dhe i përshtatjes së strukturave të sektorit të peshkimit dhe të akuakulturës

1. Inspektorati i Peshkimit kryen kontrolle në lidhje me:

a) Ristrukturimin, rinovimin dhe modernizimin e flotës së peshkimit;

b) Adaptimin e kapacitetit të peshkimit nëpërmjet ndalimit të përkohshëm dhe të përhershëm;

- c) Kufizimin e aktivitetit të anijeve të peshkimit;
 - d) Kufizimin e gjeometrisë dhe numrit të mjeteve të gjuetisë, si dhe përdorimit të tyre;
 - e) Zhvillimit të akuakulturës detare dhe vendndodhjes së tyre gjatë bregut;
 - f) Zbatimin e kushteve të licencës/kontratës/autorizimit.
2. Kontrollin kryhen për këto aspekte të anijeve të peshkimit:
- a) Kontrollin e fuqisë motorike të anijeve;
 - b) Kontrollin e peshës së regjistruar të anijeve;
 - c) Kontrollin e kohës së ndalimit të anijeve;
 - d) Kontrollin e mjeteve të peshkimit dhe numrit të tyre në anije;
 - e) Kontrollin për mundësimin e gjetjes së veglave (rrjetave) të humbura të peshkimit nëpërmjet pajisjeve përkatëse në bordin e anijes së peshkimit;
 - f) Kontrollin për investimet themelore;
 - g) Për lehtësimin e procedurave të kontrollit, inspektimi kryhet nëpërmjet kontrolleve të kryqëzuara të informacionit mbi kapacitetin e peshkimit dhe aktivitetin e akuakulturës dhe të flotës së peshkimit:
 - i) në ditarin e anijes;
 - ii) në deklaratat e zbarkimit të produktit;
 - iii) në Regjistrin Detar të anijeve të peshkimit;
 - iv) në strukturat peshkuese dhe funksionimin e aktivitetit në tërësi.

Neni 54

Kundërvajtjet, sanksionet dhe përgjegjësitë

Kundërvajtjet, sanksionet dhe përgjegjësitë e subjekteve për shkeljet e legjislacionit në fuqi, bazohen në nenet 128, 129, 130 të ligjit të peshkimit. Qëllimi i tyre, është të heqë në mënyrë efektive përfitimin ekonomik të kryer nga shkelja e konstatuar dhe të krijojë efekte në proporcion me shkallën e shkeljes së kryer, duke shërbyer si një masë penguese për shkelje të tjera të së njëjtës natyrë.

Neni 55

Procesverbali

Inspektorët e peshkimit, sa herë konstatojnë që është kryer një shkelje e ligjit dhe e kësaj rregulloreje, plotësojnë me shkrim procesverbalin sipas modelit të paraqitur në aneksin I bashkëngjitur.

Neni 56

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Edmond Panariti



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E BUJQËSISË
ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

AKT MIRATIMI I KËRKESËS

Nr. LC _____ Datë: __/__/__.

Mjeti Lundrues: _____

1.Në pronësi të _____

Adresë: _____

2.Regjistruar në Kapitenerinë e Porteve _____.

Data e Rregjistrimit: __/__/__

Nr. Regjistri _____, në Regjistrin Detar _____

Nr. Regj. në Regjistrin e mjeteve lundruese të Peshkimit _____

3.Karakteristika:

Viti i prodhimit: _____

Vendi i prodhimit: _____

Ndërtuar me material: _____

4.Përmasat:

Gjatësia __ m, gjerësia __ m, tonazhi neto, __ ton

Tipi i motorit _____

Fuqi motorike __ kw

Motora ndihmës: (Po/Jo) _____

Paisje navigimi: _____

A U T O R I Z O H E T

Të ushtrojë peshkimin profesional në zonën detare _____

Forma e peshkimit _____

Mjetet e veglat e peshkimit që do perdoren: _____

Të peshkojë llojet _____

Leja është e vlefshme deri më datën __/__/__

Vlefshmëria e kësaj leje humbet në raste mos pagimit të taksës vjetore të ushtrimit të aktivitetit deri më 31 Mars të vitit në vazhdim.

TITULLARI

Leja e lëshuar më datë _____

Taksa vjetore e lejes _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQESISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
DREJTORIA E SHERBIMEVE TË PESHKIMIT DHE AKUAKULTURËS
SEKTORI I MONITORIMIT DHE KONTROLLIT TË PESHKIMIT

Nr.Serie 0000000

AKT KONTROLLI Nr._____.

I mbajtur sot me datë _____._____._____, nga Specialisti i Monitorimit dhe Inspektimit të Peshkimit të Nënprefekturës _____, Z/Znj. _____, ne prezencë të Z/Znj. _____, _____.

Specialisti i Monitorimit dhe Inspektimit të Peshkimit në Nënprefekturën _____, në zbatim të neneve 67, 68, 109, 121 dhe 122 të ligjit Nr.64/2012, datë 31.05.2012 "Për Peshkimin" në kontrollin e ushtruar në:

Subjekti fizik/juridik: _____.

Aktiviteti: _____.

Bashkia/Komuna në të cilën ushtrohet veprimtaria: _____.

Adresa e plotë e vendit ku subjekti ushtron veprimtarinë apo ka qendrën administrative: _____.

Në prani të: Z/Znj. _____ me detyrë _____.

Konstatova sa vijon:

Subjekti e ushtron veprimtarinë me/ pa licensë/kontratë për zhvillimin e aktivitetit.

Përshkrimi i Kontrollit:

Personi përgjegjës i kontrolluar

Dëshmitari

Specialisti i Monitorimit e Kontrollit

 (Emër, mbiemër, firmë)

 (Emër, mbiemër, firmë)

 (Emër, mbiemër, firmë)

Ky Akt-Kontroll mbahet në tre kopje, një i jepet kundravajtësit, një i dërgohet MBZHRAU, një e mban Specialisti i Monitorimit e Kontrollit të Peshkimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQESISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
DREJTORIA E SHERBIMEVE TË PESHKIMIT DHE AKUAKULTURËS
SEKTORI I MONITORIMIT DHE KONTROLLIT TË PESHKIMIT

Nr.Serie 0000000

VENDIM

PËR DENIM ME GJOBË
Nr. _____, Datë _____, _____.

Specialistët e Monitorimit e Kontrollit të Peshkimit të Nënprefekturës _____, pas ushtrimit të kontrollit të veprimtarisë së peshkimit/akuakulturës të personit fizik/juridik _____, që i përket Z/Znj. _____, ne prezencë të Z/Znj. _____, në zbatim të pikës _____, të nenit _____, të ligjit Nr. 64/2012, datë 31.05.2012 "Për Peshkimin", për shkeljet e mësipërme, të cilat përbëjnë kundravajtje administrative:

VENDOSA:

1. Të dënoj me gjobë Subjektin _____, me administrator Z/Znj. _____, ne vlerën _____ (_____) lekë.
2. Të aplikojë dënimin plotësues të parashikuar në nenin Nr.129, të ligjit Nr. 64/2012, datë 31.05.2012 "Për Peshkimin":
 - a. Të sekuestrojë produktet, pajisjet dhe mjetet e peshkimit të mëposhtëme:
_____.
 - b. Të ndërprese liçensën/autorizimin/kontratën për zhvillimin e veprimtarisë Nr _____, datë _____, për një periudhë _____ (_____) muaj.
3. Të vendosë penaltitet me pikë për shkeljet e rënda, në zbatim të nenit Nr.130, të ligjit Nr. 64/2012, datë 31.05.2012 "Për Peshkimin" në masën prej _____ (_____) pikë.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim tek Ministri brenda 10 ditëve nga njohja me këtë vendim. Gjoha të derdhet në çdo bankë që ka llogari të Thesarit për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, nga që vendimi ka marrë formë të prerë. Një kopje e mandat -pagesës i dorëzohet Specialistit të Monitorimit e Kontrollit të Peshkimit. Për çdo ditë vonese pas plotësimit të kësaj afati dhe deri në një afat 30 ditor, kundravajtësi detyrohet të paguaj përveç gjobës, një shumë të barabartë me 10% të vlerës së saj. Me kalimin e afateve ligjore, ekzekutimi i vendimit të dënimit me gjobë, do të bëhet në mënyrë të detyrueshme në zbatim të ligjit Nr.10297, datë 25.05.2010 "Për Kundravajtjet Administrative".

Mora një kopje të vendimit sot më datë _____._____.

KUNDRAVAJTËSI

DISHMITARI

SPECIALISTI I MONITORIMIT E KONTROLLIT

(Emër, mbiemër, firmë)

(Emër, mbiemër, firmë)

(Emër, mbiemër, firmë)

Ky Vendim mbahet në tre kopje, një i jepet kundravajtësit, një i dergohet MBZHRAU, një e mban Specialisti i Monitorimit e Kontrollit të Peshkimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQESISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË PESHKIMIT DHE AKUAKULTURËS
SEKTORI I MONITORIMIT DHE KONTROLLIT TË PESHKIMIT

Nr.Serie 0000000

PROCES –VERBAL

I mbajtur sot me datë ____ . ____ . ____ , nga Specialisti i Monitorimit dhe Inspektimit të Peshkimit të Nënprefektures
 _____ , Z/Znj. _____ , ne prezencë të Z/Znj. _____ , _____ .

Specialisti i Monitorimit dhe Inspektimit të Peshkimit në Nënprefekturën _____ , në zbatim të nenit
 Nr. _____ , të ligjit Nr.64/2012, datë 31.05.2012 “Për Peshkimin” dhe ligjit Nr.10297, datë 20.05.2010 “Për
 Kundravajtjet Administrative”, në kontrollin e ushtruar në:

Subjekti fizik/juridik: _____ .

Aktiviteti: _____ .

Bashkia/Komuna në të cilën ushtrohet veprimtaria: _____ .

Adresa e plotë e vendit ku subjekti ushtron veprimtarinë apo ka qendrën administrative: _____ .

Në prani të: _____ .

Konstatova sa vijon:

Subjekti _____ , ka kryer: _____ .

Kur u pyet shtetasi _____ , për këtë veprim deklaroi: _____ .

Për këtë arsye, në zbatim të bazës ligjore të sipërcituar:

VENDOSA:

Të dënoj me gjobë Z/Znj. _____ , në shumën _____
 (_____) leke.

Të sekuestroj veglat dhe mjetet e mëposhtme: _____ .

Të pezullojë liçensën/kontratën e zhvillimit të veprimtarisë Nr. _____ , datë _____ , deri në
 Vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave pranë MBZHRAU-ve.

KUNDRAVAJTËSI DESHMITARI SPECIALISTI I MONITORIMIT E KONTROLLIT

(Emër, mbiemër, firmë)

(Emër, mbiemër, firmë)

(Emër, mbiemër, firmë)

Ky proces-verbal mbahet në tre kopje, një i jepet kundravajtesit, një i dergohet MBZHRAU, një e mban specialisti

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 24 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006